

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shtrenjtimi i tarifave “zbraz” bankat e shkollave private
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/shtrenjtimi-i-tarifave-zbraz-bankat-e-shkollave-private/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 07:21:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:17:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7914e96193203b18aebd89d99ed56f920c1d2cc823091d0c938eb9b6426540a8
TEKSTI	b69f4c6042c2a81d8b344f07ceba43a36ec368fbff7ad6e68a5a01bea0260231
PAMJA	c9efdf25a2f81c9c44e59f6ff35f58ed3dad6588c39f19b30e62aa527d4d427f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0e95ec531fde2e90fd7ca0b1f1fc6299d03025699f4ffffcf43218fcec94a432
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0e95ec531fde2e90fd7ca0b1f1fc6299d03025699f4ffffcf43218fcec94a432

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Shtrenjtimi i tarifave “zbraz” bankat e shkollave private

09:17 : 16/09/2026 në AKTUALITET, EKONOMI



Viti i ri shkollor ka nisur me rritje shpenzimesh për familjet që kanë zgjedhur arsimin privat.

Disa shkolla private, në nisje të fillimit të vitit të ri shkollor, shtrenjtuan tarifat e shkollimit nga 15 deri në 20%. Rritja e tarifës u aplikua për të treja ciklet e studimeve, të ulët, 9-vjeçar dhe të mesëm. Shkak i shtrenjtimit është njoftuar rritja e pagës së mësuesve dhe tarifës të transportit prej shtrenjtimit të naftës.

Por pasojat e shtrenjtimit nuk janë ndjerë vetëm për buxhetin e familjarëve. Në disa shkolla private, rritja e tarifave ka sjellë edhe largimin e një numri të konsiderueshëm nxënësish, drejt shkollave publike.

Mësuesit pohojnë se bazuar edhe në sondazhet e kryera me prindërit, arsyeja kryesore e largimeve është pikërisht rritja e koston e shkollimit.

Lexo edhe:

[Arsimi publik falas, por hyrja shtrenjtë! Sa kushton dita e parë e shkollës](#)

["Pastrimi i parave deformon tregun", Tabaku: Shqiptarët paguajnë koston e zhvlerësimit të euros](#)

Në shkollat private totali i tarifës përbëhet nga 3 zëra, tarifa e studimit, ushqimit dhe transportit.

Për shembull në një nga shkollat private tarifa totale mujore që paguante një prind për një fëmijë të ciklit të ulët ishte 15 mijë lekë studimi, 5 mijë lekë transporti dhe 6 mijë lekë ushqimi. Në total 26 mijë lekë në muaj.

Pas rritjes tarifa mujore e studimit arriti 19 mijë lekë, transporti 6 mijë lekë dhe tarifa e ushqimit 7 mijë lekë. Në total tarifa arriti 31 mijë lekë në muaj. Rritja është 5 mijë lekë apo 19 % në muaj.

Për një familje me 2 fëmijë, me rritjen e tarifave kostoja e shkollimit bëhet e

TË GJITHA



Shtrenjtimi i tarifave “zbraz” bankat e shkollave private

09:17 : 16/09/2026



Fituesja e Çmimit Nobel: Duhet ta kufizojmë inteligjencën artificiale, përndryshe njerëzit do humbasin kontrollin

09:12 : 16/09/2026



Tension para Speciales në Hagë/ Policia holandeze përplasat me mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së

08:56 : 16/09/2026



Po Vila nr. 69 në emrin e Dritan Shakohxhës në Palasë; a do hetohet nga SPAK, nëse është e Blendi Klosit?

08:39 : 16/09/2026



Gjithë sytë e shqiptarëve sot nga Haga, 3 orë nga vendimi për ish-krerët e UÇK-së

08:31 : 16/09/2026



A mund ta bëjë BE-ja Shqipërinë një vend më të aksesueshëm?

08:19 : 16/09/2026



Këmbimi valutor 16 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

08:18 : 16/09/2026

papërballueshme.

Kjo ka sjellë që për disa shkolla private largimi i nxënësve të arrijë në numër nga 3 deri në 7 nxënës në klasë. Në shkollat private numri i nxënësve varion nga 15 deri 20 nxënës për klasë. Në një klasë me 20 nxënës 7 të larguar zënë gati 35% të larguarve.

Edhe në një shkollë private të ciklit të ulët prindërit pohojnë se rritja e tarifës vjetore 500 euro apo 15% më shtrenjtë ndikoi te vendimi për largimin e fëmijës në një shkollë publike.

Një tjetër element është zgjerimi i shërbimit “pas shkolle” në arsimin shtetëror, i cili u mundëson prindërve që fëmijët të qëndrojnë më gjatë në ambientet e shkollës, edhe pas përfundimit të orarit mësimor. Ky është ende një projekt pilot, që zbatohet në disa klasa.

Ky shërbim përfshin edhe kohën e studimit dhe është kthyer në një nga avantazhet që kanë pasur shkollat private, duke bërë që shumë prindër t'i zgjedhin ato për shkak të orareve më të gjata.

Megjithatë, programi publik ende nuk përfshin ofrimin e vaktit të drekës, një shërbim që do të kishte një kosto të konsiderueshme për buxhetin.

Nga Ministria e Arsimit llogaritet se nëse programi do të zbatohet për të gjithë sistemin 9-vjeçar në vend (nga klasat e para deri në klasat e 9) kostoja vjetore arrin rreth 203 mln euro në vit. / Monitor

Etiketa: ekonomi shkolla private

Lajme të lidhura



Arsimi publik falas, por hyrja shtrenjtë! Sa kushton dita e parë e shkollës

08:57 : 14/09/2026



"Pastrimi i parave deformon tregun", Tabaku: Shqiptarët paguajnë kostot e zhvlerësimit të euros

12:47 : 05/09/2026



Singapori, ekonomia më konkurruese në botë në 2026, Azia dhe Europa dominojnë renditjen

10:59 : 04/09/2026



A ka marrë fund më në fund recesioni ekonomik në Gjermani?

08:47 : 04/09/2026



Leksione se si ulen çmimet

12:49 : 01/09/2026



Shqipëria, kampione Europe në "Ilaç e tulla", ndërton 2.5 herë më shumë se mesatarja e BE-së

09:25 : 31/08/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

